



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KËSHILLI I BOTIMEVE

Nr. 205 Prot.

Tiranë, më 1 korrik 2014

V E N D I M

Nr. 2, datë 1 korrik 2014

PËR MIRATIMIN

E

“KRITEREVE PËR BOTIM NË AKADEMINË E SHKENCAVE”

Në mbështetje të ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, neni 4, pika ç; të VKM-së nr. 150, dt. 27.02.2013 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së administratës së Akademisë së “Shkencave të Republikës së Shqipërisë”; të Statutit të Akademisë së Shkencave, neni 2, pika 7 dhe neni 22; të “Rregullores së Këshillit të Botimeve të Akademisë së Shkencave, neni 5, germa a; me propozim të Sekretarit Shkencor të ASH-së;

K O N S T A T O J:

Se është domosdoshmëri formalizimi, përmes këtij VENDIMI. i votimit të anëtarëve të Këshillit të Botimeve të Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 1 korrik 2014 (sipas procesverbalit nr. 2 bashkëmbyllur këtij vendimi), mbledhje e cila shqyrtoi draft-kriteret për botim në Akademinë e Shkencave, të parashikuara në “Rregulloren e Këshillit të Botimeve të ASH-së”. Për sa më sipër;

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Kritereve për botim në Akademinë e Shkencave”, bashkëmbyllur këtij vendimi.
2. Seksionet Shkencore të ASh-së, akademikët dhe punonjësit kërkimorë-shkencorë duhet të njihen dhe zbatojnë kriteret për botim në ASh-së.
3. Ngarkohet Sektori i botimeve edhe Bibliotekës shkencore të ASh-së për popullarizimin e kritereve, si dhe për ndjekjen e zbatimit të këtyre kritereve në vijimësi.
4. Ngarkohet Sektori i burimeve njerëzore për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretari shkencor për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

AKADEMIK MUZAFER KORKUTI

